

## A e dini?

- Çdo vit, PPO trajton mijëra **ankesa nga të burgosurit**.
- Në përgjigje të këtyre ankesave, PPO ju ka bërë pothuajse një mijë **rekomandime burgjeve** gjatë vitit të fundit.
- Rezultatet e hetimeve tona e bëjnë burgun një vend **më të drejtë e më të sigurt** për të burgosurit në të gjithë vendin.

*“Unë dhe jam i sigurt që shumë të burgosur të tjerë, janë me fat që kemi një organ të pavarur, të cilit mund t’i drejtohem për ndihmë. Ju faleminderit.”*

*I burgosuri A,  
Burgu i Mbretërisë në  
Northumberland*

## Të vërtetën rreth PPO

- Ne nuk punojmë për Shërbimin e Burgjeve, ne nuk punojmë për NOMS. PPO është **krejtësisht i pavarur**.
- Ankesat tuaja **nuk do të lexohen nga burgu** dhe nuk do të përdoren kundër jush.
- Ne marrim mijëra ankesa nga të burgosurit çdo vit. **Ne DO TA marrim tuajën.**
- Nëse jemi dakord me ju, mund të merrni një **falje; t’ju mbulohen humbjet; apo edhe të bëhet një ndryshim në mënyrën se si funksionon burgu.**
- Ne synojmë që t’i përgjigjemi ankesës tuaj **brenda 10 ditësh** pasi ta kemi marrë.

*Për çfarë mund të ankojem?*

## Për çfarë mund të ankoheni?

**Mund të ankoheni te PPO rreth çdo lloj çështjeje – që nga mënyra se si ju trajton personeli deri te sendet tuaja të humbura.**

Por, ka disa gjëra të cilat nuk mund t’i hetojmë:

- Vendimet e Bordit të Lirimit me Kusht.
- Ankesat rreth kujdesit mjekësor.
- Si rregull i përgjithshëm, nëse kanë kaluar më gjatë se 3 muaj që nga përgjigjia përfundimtare nga burgu rreth ankesës tuaj fillestare.
- Ankesa duhet të jetë rreth diçkaje që ju ka ndodhur ju, jo dikujt tjetër.

## Si të ankoheni

Si të ankohem  
te PPO?

**Sigurohuni që të ndiqni tre hapat e thjeshtë. Nëse nuk i ndiqni, ata nuk mund të hetojnë.**

- 1** Sigurohuni që fillimisht të kaloni nëpër të gjithë procesin e ankesave të burgut.
- 2** Shkruani një shënim të shkurtër për të na thënë se për çfarë është ankesa juaj dhe përse nuk jeni ende të kënaqur.
- 3** Dërgoni gjithë dokumentet tuaja tek ne – përfshirë gjithë formularët e ankesave të burgut.

## Ku ta dërgoni ankesën tuaj

Ku t'i dërgoj gjithë  
dokumentet e mia?

**Dërgojini të gjithë dokumentet e ankesave tuaja te kjo adresë:**

Prisons and Probation Ombudsman  
PO Box 70769  
London  
SE1P 4XY

Letrat që i dërgoni Avokatit të Popullit janë pa pagesë.

*"Ju falënderoj për gjithë kohën dhe përpjekjet që i keni kushtuar hetimit tuaj, e vlerësoj shumë."*

*I burgosuri B,  
Burgu i Shkëlqesisë së Saj në  
Kennet*

Prisons &  
Probation  
Ombudsman  
Independent Investigations

## Si të ankoheni tek Avokati i popullit

